



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

**DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE**

Duke u bazuar në nenin 18, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 10 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-052, për Marrëveshjet Ndërkombëtare si dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit Nr. 03/L-004 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik:

D e k r e t o j


Ratifikimin e Marrëveshjes mbi Transferimin e Personave të Dënuar, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane, e nënshkruar në Prishtinë më 14 maj 2012, dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 23 maj 2012.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN-004-2012

Prishtinë, më 01 qershor 2012


Atifete Jahjaga
Presidente e Republikës së Kosovës

MARRËVESHJE
NË MES TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
KONFEDERATËS ZVICERANE
MBI
TRANSFERIMIN E PERSONAVE
TË DËNUAR

Republika e Kosovës

dhe

Konfederata Zvicerane

Më tej “Palët Kontraktuese”

Duke dëshiruar zhvillimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e të drejtës penale;

Duke e ditur se një bashkëpunim i tillë do t'i çojë përpara synimet e drejtësisë si dhe rehabilitimin social e personave të dënuar;

Me dëshirën për t'i realizuar këto objektiva duke pasur parasysh përkushtimin e të dy shteteve lidhur me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;

Duke e ditur se këto objektiva mund të realizohen më së miri duke ua ofruar qytetarëve të huaj, të cilët janë të privuar nga liria si rezultat i kryerjes së ndonjë vepre penale, mundësinë për t'i vuajtur dënimet në atdheun e tyre; dhe

Duke e ditur se ky synim mund të arrihet më së miri duke i transferuar ata në vendet e tyre;

Janë pajtuar si vijon:

PJESA E PARË: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 - Definicionet

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje termi:

- a) “dënim” nënkupton çdo dënim ose masë, e cila përfshin privimin nga liria të urdhëruar nga një gjykatë për një periudhë të caktuar apo të pacaktuar për shkak të një veprë penale;
- b) “aktgjykim” nënkupton një vendim apo urdhër të një gjykate me të cilën shqiptohet një dënim;
- c) “shtet” nënkupton Republikën e Kosovës ose Konfederatën Zvicerane;
- d) “shtet dënues” nënkupton shtetin në të cilin është shqiptuar dënimi ndaj personit i cili mund ose tashmë është transferuar; dhe
- e) “shteti administrues” nënkupton shtetin në të cilin personi mund ose është transferuar në mënyrë që ta vuajë dënimin e tij.

Neni 2 - Parimet e përgjithshme

1. Palët Kontraktuese marrin përsipër që t'i ofrojnë njëra tjetrës bashkëpunim në shkallën më të lartë lidhur me transferimin e personave të dënuar në pajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje.
2. Personi i dënuar në territorin e njëres Palë Kontraktuese mund të transferohet në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për ta vuajtur dënimin e shqiptuar ndaj tij, në pajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje. Për këtë qëllim, ai ose ajo mund ta shpreh interesimin e saj tek shteti dënues apo tek shteti administrues për t'u transferuar në bazë të kësaj marrëveshjeje.
3. Transferimi mund të kërkohet nga shteti dënues ose nga shteti administrues.

Neni 3 - Kushtet e transferimit

1. Personi i dënuar mund të transferohet në bazë të kësaj marrëveshjeje vetëm nën kushtet vijuese:
 - a) nëse personi është shtetas i shtetit administrues;
 - b) nëse aktgjykimi është i plotfuqishëm;
 - c) nëse, në kohën e pranimit të kërkesës për transferim, personi i dënuar i ka ende së paku edhe gjashtë muaj dënim për t'i vuajtur ose nëse dënimi është i papërcaktuar;
 - d) pëlqimin për transferim e jep personi i dënuar, ose përfaqësuesi/ja ligjor/e i/e tij, në qoftë se njëra nga dy shtetet këtë e konsideron si të domosdoshme për shkak të gjendjes fizike/psikike të të dënuarit;

- e) nëse veprimet ose mosveprimet, për të cilat është shqiptuar dënimi paraqesin një vepër penale sipas ligjit të shtetit administrues ose do të paraqitnin një të tillë nëse do të kryheshin në territorin e tij; dhe
 - f) nëse shteti dënues dhe ai administrues pajtohen për transferimin.
2. Edhe në raste të veçanta/jashtëzakonshme Palët Kontraktuese mund të dakordohen për një transferim, nëse afati i miratimit të ekzekutuar ndaj personit të dënuar është më i shkurtër se sa ai i parashikuar në paragrafin 1 shkronja c.
 3. Pëlqimi i personit të dënuar sipas paragrafit 1 shkronja d nuk është i nevojshëm/domosdoshëm nëse plotësohen kushtet e caktuara në artikujt 23 dhe 24 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 4 - Klauzola e paprekshmërisë

Kjo marrëveshje i lë të paprekshme të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Palëve Kontraktuese, që burojnë drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt nga e Drejta Ndërkombëtare ose Konventa Ndërkombëtare dhe posaçërisht nga:

- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, e datës 16 dhjetor 1966;
- Konventa Evropiane e datës 4 nëntor 1950 për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
- Konventa e datës 10 dhjetor 1984 kundër Torturës dhe Trajtitimit ose Dënimit Mizor, Çnjerëzor dhe Poshtëruar.

Neni 5 - Obligimi për ofrimin e informatave

1. Secili person i dënuar ndaj të cilit aplikohet kjo marrëveshje do të informohet nga shteti dënues mbi përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje.
2. Nëse personi i dënuar ka shprehur interesim tek shteti dënues për t'u transferuar në bazë të kësaj marrëveshjeje, ky shtet do ta informojë shtetin administrues sa më shpejt që të jetë e mundur pas hyrjes në fuqi të aktgjykimit.
3. Informata duhet të përmbajë:
 - a) emrin, datën dhe vendin e lindjes së personit të dënuar;
 - b) adresën e tij, nëse ka, në territorin e shtetit administrues;
 - c) një deklaratë mbi faktet në të cilat është bazuar dënimi;
 - d) natyrën, kohëzgjatjen dhe datën e fillimit të dënimit.
4. Nëse personi i dënuar ka shprehur interesim për transferim tek shteti administrues, në bazë të kërkesës së tij shteti dënues do t'ia komunikojë shtetit administrues informatat e përshkruara në paragrafin 3.
5. Personi i dënuar do të informohet me shkrim për cilindo veprim që është ndërmarrë nga shteti dënues apo nga shteti administrues, të paraparë në

paragrafët e mësipërm, si dhe për cilindo vendim të marrë, nga secili shtet lidhur me kërkesën për transferim.

Neni 6 - Autoritetet qendrore

Për qëllime të kësaj marrëveshjeje autoriteti qendror për Republikën e Kosovës është Ministria e Drejtësisë dhe për Konfederatën Zvicerane është Zyra Federale e Drejtësisë e Departamentit Federal të Drejtësisë dhe Policisë.

Neni 7 - Kërkesat dhe përgjigjet

1. Kërkesat dhe përgjigjet për transferim do të bëhen me shkrim.
2. Kërkesat do të adresohen nga autoriteti qendror i shtetit lutës tek autoriteti qendror i shtetit të lutur. Përgjigjet do të komunikohen përmes kanaleve të njëjta.
3. Shteti i lutur do ta informojë me kohë shtetin lutës mbi vendimin e tij për pranimin ose mospranimin e kërkesës për transferim.

Neni 8 - Dokumentacioni mbështetës

1. Nëse kërkohet nga shteti dënues, shteti administrues do t'ia ofrojë atij:
 - a) një dokument ose deklaratë, në të cilën ceket se personi i dënuar është shtetas i atij shteti;
 - b) një kopje të ligjit përkatës të shtetit administrues, i cili përcakton se veprimet ose mosveprimet në bazë të të cilave është shqiptuar dënimi në shtetin dënues, përbëjnë veprë penale sipas ligjit të shtetit administrues, ose do të përbënin veprë penale në rast të kryerjes në territorin e tij.
2. Nëse kërkohet transferimi, shteti dënues do t'ia ofrojë shtetit administrues dokumentet vijuese, përveç nëse shteti tjetër tashmë ka njoftuar se nuk e miraton transferimin:
 - a) origjinalin ose kopjen e vërtetuar të aktgjykimit dhe të ligjit në të cilin ai është bazuar;
 - b) një deklaratë në të cilën ceket kohëzgjatja e dënimit tashmë të vuajtur, duke përfshirë informatat rreth paraburgimit, uljes së dënimit dhe çfarëdo faktori tjetër përkatës mbi zbatimin e dënimit;
 - c) një deklaratë e cila përmban pëlqimin për transferim që është paraparë në Nenin 3, paragrafin 1. shkronja d; dhe
 - d) eventualisht raporte nga mjekët ose punëtorët socialë lidhur me personin e dënuar, informata mbi trajtimin e tij në shtetin dënues dhe rekomandime mbi trajtimin e mëtejshëm të tij në shtetin administrues.

3. Secili shtet mund të kërkojë që të pajiset me ndonjërin nga dokumentet apo deklaratat e parapara në paragrafët 1 dhe 2, para parashtrimit të kërkesës për transferim, ose marrjes së vendimit për lejimin ose refuzimin e transferimit.

Neni 9 - Pëlqimi dhe verifikimi i tij

1. Shteti dënues do të sigurohet që personi nga i cili kërkohet që ta japë pëlqimin për transferim, në pajtim me Nenin 3, paragrafin 1. shkronja d, këtë e bën vullnetarisht dhe me vetëdije të plotë mbi pasojat ligjore që rrjedhin nga ai. Procedura për dhënien e një pëlqimi të tillë duhet të rregullohet me ligjin e shtetit dënues.
2. Shteti dënues do t'ia ofrojë mundësinë shtetit administrues që përmes konsullit ose ndonjë zyrtari tjetër të akorduar me shtetin dënues të verifikojë nëse pëlqimi është dhënë në pajtim me kushtet e parapara në paragrafin 1 si më lart.

Neni 10 - Revokimi i pëlqimit

Pëlqimi i personit të dënuar është i paryokueshëm pasi që palët të pajtohen lidhur me transferimin e tij.

Neni 11 - Efekti i transferimit për shtetin dënues

1. Pranimi i personit të dënuar nga autoritetet e shtetit administrues do të ketë efekt në suspendimin e zbatimit të dënimit në shtetin dënues.
2. Nëse personi i dënuar arratiset pas transferimit, shteti dënues e fiton të drejtën që ta zbatojë pjesën e dënimit të cilin ky person do të duhej ta vuante në shtetin administrues.
3. Shteti dënues mund të mos e zbatojë dënimin më tej nëse shteti administrues konsideron se zbatimi i dënimit ka përfunduar.

Neni 12 - Efekti i transferimit për shtetin administrues

1. Autoritetet kompetente të shtetit administrues:
 - a) në rastin e Republikës së Kosovës do ta konvertojnë dënimin përmes procedurës gjyqësore apo administrative me një vendim të atij shteti duke e zëvendësuar dënimin e shqiptuar në Konfederatën Zvicerane me një dënim të paraparë me ligjin e Republikës së Kosovës për të njëjtën vepër penale, në bazë të kushteve të parapara në Nenin 13 paragrafi 1, ose.
 - b) në rastin e Konfederatës Zvicerane do ta vazhdojnë zbatimin e dënimit menjëherë ose përmes urdhëresës së gjykatës apo asaj administrative në bazë të kushteve të parapara në Nenin 13 paragrafin 2.

2. Zbatimi i dënimit do të rregullohet me ligjin e shtetit administrues dhe vetëm ai shtet është kompetent për marrjen e vendimeve të duhura.

Neni 13 - Vazhdimi i zbatimit dhe konvertimi i dënimit

1. Në rast të konvertimit të dënimit në pajtim me Nenin 12, paragrafi 1. shkronja a, do të aplikohen procedurat e parapara me ligjin e Republikës së Kosovës. Gjatë konvertimit të dënimit, autoriteti kompetent:
 - a) u detyrohet konstatimeve faktike, përveç nëse ato rrjedhin nga një urdhëresë e nxjerrë nga aktgjykimi i shqiptuar në Konfederatën Zvicerane;
 - b) nuk guxon ta konvertojë dënimin me privim lirie në një dënim me gjobë;
 - c) do ta zbrësë periudhën e plotë të privimit të lirisë që është vuajtur nga personi i dënuar; dhe
 - d) nuk guxon ta vështirësojë pozitën penale të personit të dënuar dhe nuk i detyrohet asnjë minimumi, të cilin ligji i Republikës së Kosovës e parasheh për veprën ose veprat e kryera penale.
2. Në rast të vazhdimit të zbatimit në pajtim me Nenin 12, paragrafin 1. shkronja b, Konfederata Zvicerane lidhet me natyrën juridike dhe kohëzgjatjen e dënimit, siç është përcaktuar në Republikën e Kosovës.

Nëse megjithatë ky dënim për kah natyra ose kohëzgjatja e tij është në papajtueshmëri me ligjin e Konfederatës Zvicerane, Konfederata Zvicerane përmes një urdhërese të gjykatës ose urdhërese administrative mund ta adaptojë dënimin ose masën për veprën të ngjashme penale e paraparë me ligjin e saj. Sa i përket natyrës së tij, dënimi ose masa duhet që për aq sa është e mundur të korrespondojë me atë që është shqiptuar në dënimin që do të zbatohet. Ai nuk guxon ta vështirësojë, qoftë për shkak të natyrës apo kohëzgjatjes, sanksionin e shqiptuar në Republikën e Kosovës, e as ta tejkalojë maksimumin e paraparë me ligjin e Konfederatës Zvicerane.

3. Para transferimit shteti administrues ia dorëzon shtetit dënues vendimin me përmbajtjen e dënimit.

Neni 14 - Pasojat e transferimit

1. Personi, i cili transferohet në bazë të kësaj marrëveshjeje nuk do të ndiqet dhe nuk do të dënohet në shtetin administrues për veprën penale për të cilën ai është dënuar në shtetin dënues.
2. Megjithatë shteti administrues mund ta paraburgosë, ndjekë dhe dënojë personin e transferuar për ndonjë veprën penale për të cilën ai nuk është dënuar

në shtetin dënues, me kusht që vepra penale të ndiqet në pajtim me ligjin e shtetit administrues.

Neni 15 - Amnistia, Zbutja ose Falja

Secili shtet mund ta amnistojë ose ta zbusë dënimin në pajtim me ligjet e veta, me kusht që aktet e tilla të jenë të aplikueshme në përgjithësi. Shteti administrues me pëlqimin e shtetit dënues mund ta miratojë faljen në pajtim me ligjet e tij.

Neni 16 - Rishqyrtimi i aktgjykimit

Vetëm shteti dënues ka të drejtë të vendosë mbi aplikimin e rishqyrtimit të aktgjykimit.

Neni 17 - Përfundimi i zbatimit

Shteti administrues do ta përfundojë zbatimin e dënimit menjëherë pas informimit nga shteti dënues mbi ndonjë vendim apo masë, si rezultat i së cilës dënimi pushon të jetë i zbatueshëm.

Neni 18 - Informimi mbi zbatimin

Shteti administrues do t'i ofrojë informata shtetit dënues lidhur me zbatimin e dënimit:

- a) kur ai konsideron se zbatimi i dënimit është përfunduar;
- b) kur personi i dënuar arratiset para përfundimit të dënimit; ose
- c) kur shteti dënues kërkon raport të veçantë.

Neni 19 - Skuadra e shoqërimit/Eskorta dhe shpenzimet

1. Shteti dënues e siguron eskortën për transferim dhe i bart të gjitha shpenzimet lidhur me transferimin, përveç nëse autoritetet qendrore vendosin ndryshe.
2. Shteti administrues e pranon personin e dënuar jo më vonë se 30 ditë pas pajtimit të palëve mbi transferimin. Nëse është e nevojshme, ky afat kohor mund të zgjatet sipas kërkesës.

Neni 20 - Kalimi tranzit

1. Nëse njëra nga Palët Kontraktuese e transferon personin e dënuar nga ndonjë vend i tretë, Pala tjetër Kontraktuese do të bashkëpunojë për ta lehtësuar

kalimin transit të personit nëpër territorin e saj. Pala Kontraktuese e cila synon ta bëjë një transferim të tillë transit e njofton Palën tjetër Kontraktuese paraprakisht.

2. Secila palë mund ta refuzojë kalimin transit:
 - a) nëse personi i dënuar është shtetas i saj; ose
 - b) nëse vepra penale për të cilën është shqiptuar dënimi nuk paraqet vepër penale sipas ligjit të saj.

Neni 21 - Gjuha

1. Dokumentet e shkëmbyera sipas kësaj marrëveshjeje duhet të jenë të shoqëruara me një përkthim në gjuhën e shtetit, të cilit i adresohen.
2. Gjuha përcaktohet në secilin rast nga autoriteti qendror:
 - a) për Republikën e Kosovës: gjuha shqipe ose serbe;
 - b) për Konfederatën Zvicerane gjuhët: gjermane, frënge ose italiane.

Neni 22 - Përjashtimi nga legjislacioni, autenticiteti dhe kërkesat tjera formale

Përveç rasteve të parapara në Nenin 8 paragrafi 2. shkronja a, dokumentet e shkëmbyera gjatë aplikimit të kësaj marrëveshjeje do të jenë të përjashtuara nga legjislacioni, autenticiteti dhe kërkesat tjera formale.

PJESA E DYTË: DISPOZITAT E VEÇANTA LIDHUR ME TRANSFERIMIN DHE PRANIMIN E EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT PA PËLQIMIN E PERSONIT TË DËNUAR

Neni 23 - Personat që janë arratisur nga shteti dënues

1. Nëse një shtetas/e e njërës Palë Kontraktuese, kundër të cilit/cilës është shpallur/dhënë dënimi si pjesë përbërëse e një vendimi të plotfuqishëm në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, mundohet t'i shmanget zbatimit të dënimit në shtetin dënues, me ç'rast arratiset në territorin e Palës së Parë Kontraktuese para vuajtjes së dënimit, shteti dënues mund të kërkojë nga Pala tjetër Kontraktuese ta marrë përsipër ekzekutimin e dënimit.
2. Me kërkesën e shtetit dënues, shteti administrues në pajtim me ligjin e tij të brendshëm, para arritjes së dokumenteve që e mbështesin kërkesën ose para vendimit mbi atë kërkesë, mund ta arrestojë personin e dënuar ose të ndërmarrë çfarëdo mase tjetër për t'u siguruar se personi i dënuar do të mbetet në territorin

e tij në pritje të vendimit mbi kërkesën. Kërkesat për masa të përkohshme do të përfshijnë informatën e përmendur në Nenin 5 paragrafin 3 të marrëveshjes. Pozita penale e personit të dënuar nuk guxon të vështirësohet si rezultat i ndonjë periudhe të kaluar nën arrest në bazë të këtij paragrafi.

3. Pëlqimi i personit të dënuar nuk do të kërkohej lidhur me transferimin e ekzekutimit të dënimit.

Neni 24 - Personat e dënuar, subjekt të urdhrimit për dëbim ose deportim

1. Në bazë të kërkesës së bërë nga shteti dënues, shteti administrues në pajtim me dispozitat e këtij neni, mund të pajtohet me transferimin e personit të dënuar pa pëlqimin e atij personi, kur dënimi i shqiptuar kundër këtij të fundit, ose ndonjë urdhëresë administrative e cila rrjedh nga dënimi përfshin urdhëresën për dëbim ose deportim ose çfarëdo mase tjetër, si rezultat i së cilës ai nuk do të lejohet që të qëndrojë më tej në territorin e shtetit dënues, që nga momenti i lirimimit të tij nga burgu.
2. Shteti administrues nuk e jep pëlqimin e tij për qëllimet e paragrafit 1 pa e marrë parasysh mendimin e personit të dënuar.
3. Me qëllim të aplikimit të këtij neni shteti dënues i ofron shtetit administrues:
 - a) një deklaratë e cila përmban mendimin e personit të dënuar lidhur me transferimin e paraparë të tij; dhe
 - b) një kopje të urdhrimit për dëbim ose deportim ose çfarëdo urdhri tjetër, sipas të cilit personit të dënuar që nga momenti i lirimimit të tij nga burgu nuk do t'i lejohet më tej qëndrimi në territorin e shtetit dënues.
4. Një person i transferuar në bazë të dispozitave të këtij neni guxon të ndiqet, dënohet, ta mbajë dënimin, të paraburgoset, ose t'i cënohet e liria e tij personale për ndonjë veprë tjetër penale të kryer para kryerjes së veprës për të cilën transferohet, vetëm atëherë:
 - a) kur shteti dënues e autorizon këtë; kërkesa për autorizim duhet të dorëzohet e shoqëruar nga të gjitha dokumentet përkatëse dhe procesverbali ligjor i çfarëdo deklarate të bërë nga personi i dënuar. Autorizimi do të jepet kur vepra penale për të cilën ai kërkohej do të ishte lëndë e ekstradimit në bazë të ligjit të shtetit dënues ose kur ekstradimi do të përjashtohet vetëm për arsye të masës së dënimit;
 - b) kur personi i dënuar edhe pse e ka pasur mundësinë e largimit nga territori i shtetit administrues brenda 45 ditësh pas lirimimit të tij përfundimtar, nuk e ka bërë një gjë të tillë, ose kur ai është kthyer në atë territor pasi që të jetë larguar nga ai.
5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 4, shteti administrues mund të marrë çfarëdo masash të nevojshme në bazë të ligjit të tij, duke përfshirë *in absentia* për të parandaluar çfarëdo efekti ligjor nga kalimi i kohës.

PJESA E TRETË: DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 25 - Konsultimet

Të dy Palët Kontraktuese do të konsultohen, me kërkesën e cilëso Palë Kontraktuese, lidhur me interpretimin, aplikimin ose implementimin e marrëveshjes në fjalë në përgjithësi ose lidhur me ndonjë rast në veçanti.

Neni 26 - Aplikimi i përkohshëm

Kjo marrëveshje do të aplikohet për zbatimin e dënimeve të shqiptuara para ose pas hyrjes së tyre në fuqi.

Neni 27 - Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi 30 ditë pas pranimit të notës së fundit diplomatike, përmes së cilës Palët Kontraktuese e informojnë njëra tjetrën mbi përbushjen e kushteve të parapara nga legjislacioni vendor mbi hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Neni 28 - Shfuqizimi

1. Secila Palë Kontraktuese mund ta shfuqizojë këtë marrëveshje në çdo kohë përmes njoftimit me shkrim të Palës tjetër Kontraktuese. Shfuqizimi do të hyjë në fuqi gjatë muaj pas datës së pranimit të njoftimit.
2. Megjithatë marrëveshja do të vazhdojë të aplikohet për zbatimin e dënimeve të personave të cilët janë transferuar në pajtim me dispozitat e saj para datës së hyrjes në fuqi të shfuqizimit të marrëveshjes.

NË DËSHMI TË KËSAJ, nënshkruesit, duke qenë të autorizuar në mënyrë të rregullt nga Qeveritë e tyre e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

E përgatitur në dy kopje, në Prishtinë, më 14 Maj 2012, në gjuhët shqipe, serbe, gjermane dhe angleze, ku secili tekst është autentik në mënyrë të barabartë. Në rast të divergjencave mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

Për Republikën e Kosovës:

Hajredin KUÇI

Zëvendëskryeministër
dhe Ministër i Drejtësisë

Për Konfederatën Zvicerane:

Krystyna MARTY LANG

Ambasadore